

Raport i Politikave mbi Zbatimin e Rregullores Nr. 08/2011 mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian



**Raport i Politikave mbi Zbatimin e
Rregullores Nr. 08/2011 mbi Organizimin
dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për
Integrim Evropian**

Përgatitur nga: Dr. Albana Rexha

Design: Envinion

Copyright© 2021. **Democracy Plus (D+)** dhe **Konrad-Adenauer-Stiftung** Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet ose të transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues ose tjetër, pa lejen e D+.

Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht pikëpamjet e Konrad Adenauer Stiftung.

Ky botim i Konrad-Adenauer-Stiftung është i synuar vetëm për informacion. Ai nuk mund të përdoret nga partitë politike ose nga fushatat a mbështetësit e zgjedhjeve me qëllim të reklamimit të zgjedhjeve. Kjo vlen për zgjedhjet federale, shtetërore dhe lokale, si dhe zgjedhjet për Parlamentin Evropian.

*Ky shënim politikash është shkruar në gjuhën angleze, andaj për çdo paqartësi në këtë version të përkthyer dhe përshtatur, të lutem konsultohuni me versionin origjinal "Policy Report on the Application of Regulation No.08/2011 on Organization and Responsibilities of Municipal Offices for European Integration"

Përmbajtja

Përmbledhje e përgjithshme	6
Hyrje	9
Metodologjia	11
Roli i Komunave në Procesin e Integrit Evropian	12
Vlerësimi i zbatimit të Rregullores nr. 08/2011	18
Ekzistenca e Zyrës Komunale për Integrim Evropian	18
Përmbushja e funksioneve të saj	19
Përmbushja e detyrave dhe përgjegjësive të saj	22
Bashkëpunimi me institucionet qendrore	26
Vlerësimi i nevojave për ndërtimin e kapaciteteve	29
Konkluzione dhe rekomandime të politikave	34
SHTOJCA A: Anketë mbi rolin e Komunës në Procesin e Integrit Evropian	36
SHTOJCA B: Informacioni i kontaktit në lidhje me Zyrat e Integrit Evropian në Komunitat e Kosovës dhe nëpunësit civilë	40

Përmbledhje e përgjithshme

Zyrat Komunale për Integrim Evropian mbeten strukturat e vetme vertikale për avancimin e agjendës së BE-së në nivelin lokal. Roli i tyre përshkruhet në Rregulloren Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian, zbatimi i plotë i të cilës është thelbësor për sigurimin e një roli të suksesshëm komunal në procesin e integritimit evropian të Kosovës

Qëllimi i këtij raporti politik është që ta shqyrtojë rolin e komunave në procesin e integritimit në BE, në veçanti shkallën në të cilën zbatohet Rregullorja nr. 08/2011 mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian në të gjitha komunat e Kosovës dhe të avokojë për zbatimin e saj të suksesshëm, duke i fuqizuar kështu këto zyra.

Ky raport i politikave ka përdorë një qasje cilësore për ta vlerësuar zbatimin e Rregullores nr. 08/2011 pasi shumica e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të vlerësuara janë të natyrës koordinuese, mbështetëse e ndihmëse. Për vlerësimin e këtyre roleve, ka nevojë që të mblidhen të dhëna të dorës së parë, duke përfshirë perceptimet nga aktorët kryesorë të përfshirë. Kështu, për këto qëllime, ky raport i politikave ka përdorë metodën e triangulimit të të dhënave duke përfshirë a) marrjen e të dhënave nga webfaqet e 38 komunave, b) kry-

erjen e intervistave me aktorët kryesorë përfshirë MAPL-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, c) realizimin e një fokus grupi me punonjësit civilë të integritimit evropian nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj), dhe d) zhvillimin e një anketimi në internet me të gjithë nëpunësit civilë të integritimit evropian nga 38 komunat.

Analiza demonstroi se Rregullorja nr. 08/2011 ka zbatim të kufizuar në të gjitha komunat e Kosovës. Një numër sfidash e problemesh të identifikuara përfshijnë: dy komuna nuk kanë Zyrë për Integrim Evropian; shumica e nëpunësve civilë komunalë të integritimit evropian nuk janë këshilluar kurrë për caktimin e prioritetëve lokale të politikave publike; më se gjysma e tyre rrallë ose kurrë nuk këshillohen për hartimin e buxhetit komunal ose nuk ftohen në grupe punuese për të hartuar rregulloret ose strategjitë komunale; gjysma nuk janë trajnuar kurrë se si të aplikojnë për fonde të BE-së dhe më se gjysma nuk kanë aplikuar kurrë për asnjë lloj fondi të BE-së; rreth 70% e nëpunësve civilë ftohen rrallë ose nuk ftohen kurrë në mbledhjen e këshillit të drejtorëve të udhëhequr nga Kryetari i Komunës.

Ky raport i politikave ka përdorë një qasje cilësore për ta vlerësuar zbatimin e Rregullores nr. 08/2011 pasi shumica e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të vlerësuara janë të natyrës koordinuese, mbështetëse e ndihmëse. Për vlerësimin e këtyre roleve, ka nevojë që të mblidhen të dhëna të dorës së parë, duke përfshirë perceptimet nga aktorët kryesorë të përfshirë. Kështu, për këto qëllime, ky raport i politikave ka përdorë metodën e triangulimit të të dhënave duke përfshirë



a) marrjen e të dhënave nga webfaqet e 38 komunave



b) kryerjen e intervistave me aktorët kryesorë përfshirë MAPL-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës



c) realizimin e një fokus grupi me punonjësit civilë të integritit evropian nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj)



d) zhvillimin e një anketimi në internet me të gjithë nëpunësit civilë të integritit evropian nga 38 komunat.

Prandaj, ky raport politikash rekomandon dhe ofron arsyetim të gjerë për rekomandimet e mëposhtme të bazuara në prova:

- Mitrovica e Jugut dhe Graçaninca duhet të themelojnë një Zyrë Komunale për Integrim Evropian dhe kjo Zyrë duhet të veprojë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës përkatëse, në përputhje me nenin 2 të Rregullores nr. 08/2011.
- Me të marrë detyrën, çdo Kryetar Komune me stafin e vet ekzekutiv duhet të informohet për rolin dhe funksionet e Zyrës. Për më tej, Rregullorja nr. 08/2011 duhet t'u sigurohet atyre përmes cilitdo kanal komunikimi. Marr këtë parasysh, do të ulej shpeshësia e problemeve të hasura gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të të dhënave.
- Të gjithë kryetarët e komunave duhet t'i ftojë nëpunësit civilë të integritit evropian gjatë takimit të këshillit të drejtorëve. Marr këtë parasysh, ata do të informohen rreth planeve dhe aktiviteteve komunale dhe do të kenë mundësi të japin komentet e tyre.
- Të gjitha kabinetet e kryetarëve të komunave dhe drejtorët e departamenteve duhet të këshillohen me nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian për caktimin e përparësive të politikave publike lokale që t'i çojnë përpara reformat e dala nga agjenda e BE-së.
- Nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian duhet të konsultohen kur hartohet buxheti komunal, pasi dimensionin e buxhetit mbetet parakushti kryesor për zbatimin e çdo politike publike lokale.
- Nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian duhet të trajnohen lidhur me aplikimin për fonde të BE-së.
- Rregullorja nr. 08/2011 duhet të ndryshohet për të rishikuar rolin e bashkëpunimit të këtyre Zyrave me Ministrinë e Financave dhe Zyrën për Integrim Evropian (ish Ministria e Integritit Evropian)

HYRJE

Përparimi i rrugëtimit të Kosovës drejt Integritimit Evropian dhe përafrimi me BE mbeten prioritetet kryesore strategjike për institucionet e Kosovës dhe partitë politike. Në këtë kontekst, më 2015 Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) si marrëveshjen e parë kontraktuale me BE-në. Me nënshkrimin e MSA-së, mbas një viti, më 2016, Kosova ka hartuar Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe është pajtuar të zbatojë një varg reformash të shpërndara në tri blloqe: a) Politike, b) Ekonomike dhe c) Standarde Evropiane - Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis të BE-së. Për më tej, janë krijuar disa mekanizma, të ashtuquajtur struktura të MSA-së, në nivelin kombëtar, për të siguruar bashkërendim të qetë ndërinstitucional dhe për ta diskutuar hapur progresin/regresin në secilën fushë të politikave. Këto struktura përfshijnë Këshillin e Stabilizim Asociimit - strukturë kjo e nivelit të lartë politik, Komitetin - strukturë e nivelit teknik, shtatë

nën-komitete që adresojnë politikat sektoriale dhe dy nën-komitete speciale, përfshi atë për administratën publike dhe për normalizimin.

Asnjëra nga strukturat e mësipërme nuk përfshin nivelin lokal, e megjithatë një numër i madh reformash të MSA-së bie nën përgjegjësinë e nivelit lokal, ndonëse vetë komuna nuk përmendet si institucion përgjegjës nën PKZMSA. Në përbërjen aktuale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) identifikon të gjitha reformat që bien nën nivelin lokal në dokumente si PKZMSA dhe raporti i vendit. MAPL raporton edhe në emër të të gjitha komunave të Kosovës në zyrën për Integritim Evropian tek Zyra e Kryeministrit (ish Ministria e Integritimit Evropian)¹. Nga ana tjetër, të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse për të zbatuar cilëndo reformë të MSA-së, raportojnë drejtpërdrejt në zyrën për integritimin në BE në Zyrën e Kryeministrit



Ky raport i politikave është strukturuar si vijon: seksioni i dytë adreson metodologjinë; seksioni i tretë diskuton rolin e komunës në procesin e integritimit evropian; seksioni i katërt diskuton rezultatet e vlerësimit të aplikimit të Rregullores nr. 08/2011; seksioni i pestë ofron përfundimet dhe rekomandimet e politikave.

¹ Intervistë me Shkelqim Jakupin, Drejtor i Departamentit për Integritim në BE dhe Koordinim të Politikave. 11 Mars 2021. Prishtinë.

Roli i komunës në avancimin e agjendës së BE-së rregullohet përmes Rregullores nr. 08/2011 mbi Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian, sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe e zbatueshme që nga viti 2011. Zyrat lokale për Integrim Evropian që rrjedhin nga kjo Rregullore janë mekanizmi i vetëm vertikal në nivelin lokal, përgjegjës për të kryer dhe koordinuar procesin e integrimit evropian.

Ky raport i politikave është strukturuar si vijon: seksioni i dytë adreson metodologjinë; seksioni i tretë diskuton rolin e komunës në procesin e integrimit evropian; seksioni i katërt diskuton rezultatet e vlerësimit të aplikimit të Rregullores nr. 08/2011; seksioni i pestë ofron përfundimet dhe rekomandimet e politikave.

METODOLOGJIA

Për vlerësimin e zbatimit të Rregullores nr. 08/2011, ky raport politikash përdor një qasje cilësore dhe përdor metodën e triangulimit të të dhënave, duke përfshirë:

- 1 Kërkime në 38 uebfaqe komunale për nxjerrjen e të dhënave,
- 2 Intervistat e kryera me aktorët kryesorë, përfshirë MAPL-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës,
- 3 Kryerjen e një fokus grupi me nëpunës civilë komunalë për integrim evropian nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj),
- 4 Kryerjen e një anketiminë internet me të gjithë nëpunësit civilë të integritit evropian nga 38 komunat. Pyetësi ishte në të dy gjuhët: shqip dhe serbisht. Pyetësi përmban 20 pyetje, siç tregohet në Shtojcën I.

Për më tej, janë konsultuar dokumente të tjera në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me rolin e komunave në këtë proces.

ROLI I KOMUNAVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Kjo pjesë diskuton rolin e përgjithshëm të komunave dhe përgjegjësitë që mbajnë drejt avancimit dhe koordinimit të Agjendës Evropiane në nivelin lokal.

Roli i komunave në procesin e integritit në BE është qëndror, megjithëse siç u përmend më lart, vetë komunat nuk janë të renditura në kornizën kryesore të politikave - PKZMSA, si institucion përgjegjës për zbatimin e masave specifike. Ato vazhdimisht angazhohen në avancimin e agjendës Evropiane ndërsa zbatojnë veprime specifike si sigurimi i strehimit, edukimi i fëmijëve, e shërbimet publike komunale për të kthyerit, ndër të tjera². Këto dhe veprime të tjera të ngjashme janë detyrim i MAPL-së dhe komunave si pjesë e riintegritit të personave të riatdhesuar, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Riintegritin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar³. Kjo strategji gjithashtu kërkon fuqizimin e mëtejshëm të aktorëve lokalë në këtë drejtim.

Ministria e Administratës Publike Lokale (MAPL), për çdo vit monitoron zbatimin e Agjendës Evropiane të Reformës në nivelin lokal. Kriteret politike në nivelin lokal raportojnë mbi zbatimin e reformave në lidhje me administratën publike, avokatin e popullit, shoqërinë civile, luftën kundër terrorizmit, trashëgiminë kulturore; kriteret ekonomike përfshijnë reformat në lidhje me një ekonomi funksionale, taksat, ndërmarrjet dhe tregun e brendshëm; standardet e BE-së përfshijnë bujqësinë dhe zhvillimin rural, energjinë, gjyqësorin dhe të drejtat themelore, mbrojtjen e pakicave, drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, menaxhimin e kufijve, shëndetin publik, ndër të tjera.

2 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe (2014) "Udhëzime për rolin e komunave në procesin e integritit në BE". Republika e Kosovës.

3 Ministria e Punëve të Brendshme "Strategjia Kombëtare për Riintegritin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2018-2022" Republika e Kosovës.

Zbatimi i përgjithshëm i masave në Agjendën e Reformës Evropiane në nivelin lokal




Table 1. Zbatimin e përgjithshëm të këtyre masave, të ndara në të tri kategori: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet e BE-së për 2019-2020.

Burimi: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Raporti i përbushjes së obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane. 2021

Të dhënat janë mbledhë nga të gjithë nëpunësit civilë të Integritimit Evropian nëpër komuna. MAPL verifikon këto të dhëna në terren kur është e nevojshme.⁴Të dhënat e vitit 2020 tregojnë se komunat kanë rezultuar më keq krahasuar me vitin 2019, prandaj është me rëndësi të theksohet se kjo performancë më e ulët është e pranishme për shkak të kufizimeve të COVID-19 që çojnë në anulimin e aktiviteteve të ndryshme lokale të planifikuara në të tria kategoritë. Këto raporte të MAPL përfshijnë gjithashtu një seksion mbi rekomandimet në varësi të asaj që duhet bërë

Për më tej, edhe roli i komunave në zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave që nga viti 2012 ka qenë i madh. Detyrimet që rrjedhin nga ky udhërrëfyes kishin të bënin me demokratizimin, sundimin e ligjit dhe miratimin e Acquis Communautaire, ndërsa një numër i këtyre detyrimeve binin nën përgjegjësinë e nivelit lokal. Në këtë kontekst, MAPL me qëllim të mbështetjes së zyrave të nivelit lokal, ka identifikuar disa veprime që bien nën përgjegjësinë e komunave, duke përfshirë të drejtat e njeriut, fuqizimin e zyrave lokale për të kthyerit dhe komunitetet, zbatimin e kodit të etikës, e të ngjashme.⁵

MAPL ka hartuar edhe një dokument udhëzues në të cilin diskuton rolin e komunës në procesin e integritimit në BE të titulluar "Udhëzime për rolin e komunave në procesin e integritimit në BE".⁶ Në këtë dokument udhëzues, MAPL bazohet në përgjegjësitë e vetë MAPL-së dhe ato të nivelit lokal, ndërsa thekson detyrimet që rrjedhin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, strategjinë kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregulloren nr. 08/2011 . Ky mbetet dokumenti i vetëm në nivelin qendror që adreson rolin e nivelit lokal në procesin e Integritimit Evropian të Kosovës.⁷

Për më tej, miratimi i Rregullores nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Lokale për Integrim Evropian shënoi një hap të rëndësishëm për qartësimin e rolit dhe të funksioneve të Komunës në këtë proces. Sipas kësaj rregulloreje, secila komunë duhet të themelojë një Zyrë lokale për Integrim Evropian nën mbikëqyrjen e Kryetarit, ndër të tjera.⁸ Edhe pse këto zyra u krijuan më 2011, ato vetëm më 2015 u bënë funksionale.⁹

I kemi pyetur nëpunësit civilë komunalë të integritimit evropian për mendimet mbi rolin e komunës në këtë proces dhe për shkallën në të cilën zbatohet Rregullorja nr. 08/2011. Sipas të dhënave të perceptimit, pak nga ata e shohin rolin e komunës si të rëndësishëm dhe thelbësor në procesin e integritimit evropian të Kosovës, e disa të tjerë e shohin si jo të mbështetur fuqimisht nga niveli qendror ose si mesatarisht të mirë, pa shtjelluar më tej se çka nënkuptojnë.¹⁰ Më poshtë po citojmë disa nga mendimet e tyre lidhur me rolin e bashkisë në procesin e integritimit evropian.

4 Intervistë me Shkelqim Jakupin, Drejtor i Departamentit për Integrim në BE dhe Koordinim të Politikave. 11 Mars 2021. Prishtinë.

5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. (2014). "Udhëzime për rolin e komunave në procesin e integritimit në BE" Republika e Kosovës.

6 Ibid.

7 Intervistë me Shkelqim Jakupin, Drejtor i Departamentit për Integrim në BE dhe Koordinim të Politikave. 11 Mars 2021. Prishtinë.

8 Për më shumë shih "Rregulloren Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës. Neni 2. Zyra Komunale për Integrim Evropian.

9 ibid

10 Rezultatet nga anketa online me të gjithë nëpunësit civilë të Integritimit Evropian nga niveli komunal (38 komuna). Anketat u plotësuan më 20 -27 Prill 2021. Ato u dërguan në të dyja gjuhët. Ne morëm përgjigje nga 27 komuna.



“Roli i komunës në këtë proces është shumë i rëndësishëm pasi shumë nga detyrimet që rrjedhin nga agjenda kombëtare e BE duhet të zbatohen nga komunat”¹¹



“Duke marrë parasysh faktin se të gjitha reformat fillojnë nga komunat, përfshirë shërbimet publike, arsimin fillor dhe të mesëm, shërbimet shëndetësore parësore, regjistrimin civil, unë mendoj se roli i komunës është shumë i rëndësishëm. Është me rëndësi edhe që veprimet e komunës të jenë në përputhje me objektivat e BE-së.”¹²



“Unë e shoh rolin e komunës në këtë proces si sfidues dhe pak të mbështetur nga niveli qendror.”¹³



“Rol aktiv dhe mbështetës”¹⁴



“Unë e shoh rolin e komunës si të vakët dhe jo thelbësor”¹⁵

11 Ibid

12 Ibid

13 Ibid

14 Ibid

15 Ibid

Lidhur me zbatimin e Rregullores nr. 08/2011, nga 1-5 (sa më afër 5, aq më i mirë aplikimi), rezultati mesatar nga 27 nëpunës civilë që i janë përgjigjë pyetësorit tonë në internet është 2.78. Sipas perceptimeve të tyre, rezultati prej 2.78/5 demonstroi zbatim të kufizuar të Rregullores nr. 08/2011.



Për më tej, Kosova ka themeluar Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) bazuar në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.¹⁶ AKK është organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e anëtarëve të saj lokalë dhe synon të krijojë një qeveri lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike. AKK-ja ka 17 kolegji dhe secili shërben si mekanizëm themelor për t'i mbledhë drejtorët e departamenteve komunale dhe nëpunësit civilë. Nëpunësit civilë që janë pjesë e zyrave lokale për integrim në BE formojnë një Kolegjium, të ashtuquajturat Kolegjiume të Integritit në BE.¹⁷ Ndryshe nga Kolegjiumet e tjera që përbëhen nga anëtarë që mbajnë poste politike në komunë, anëtarët e këtij Kolegjiumi janë të gjithë nëpunës civilë.

Kolegjiumi i Integritit në BE është organ që mbledhet tri deri në gjashtë herë në vit për të diskutuar dhe identifikuar nevoja dhe sfida të ndryshme të nëpunësve civilë që punojnë për integrimin në BE si pjesë e zyrave lokale të integritit në BE. Organi i ko-

legjeve shërben mirë për t'i lidhë të gjithë nëpunësit civilë nëpër komuna dhe i ndihmon t'i artikulojnë më mirë nevojat. Sipas kreut të këtij Kolegjiumi, për t'i fuqizuar këta nëpunës civilë në nivelin lokal, u kemi dërguar letra zyrtare kryetarëve të komunave dhe u kemi kërkuar që të ftojnë nëpunës civilë për integrimin në BE në çdo takim komunal me drejtorët komunalë.¹⁸ Me këtë parasysh, nëpunësit civilë duhet të përditësohen me agjendën dhe veprimet e projekteve komunale për t'ia ofruar ekspertizën e tyre kryetarit dhe komunës. Për më tej, ky Kolegjium është pjesë e Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore (NALAS). Anëtarët e Kolegjiumeve ftohen shpesh në trajnime dhe ngjarje të ndryshme, por nuk përfaqësohen gjithmonë. Mungesa e vullnetit politik për t'i mbështetur ato financiarisht, mungesa e të drejtës për të udhëtuar lirshëm nëpër Evropë pa vizë, dhe mungesa e aftësive të gjuhës angleze janë disa nga pengesat e zakonshme.¹⁹

16 Për më shumë shih Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Neni 10. Autoritetet lokale kanë të drejtë, gjatë ushtrimit të kompetencave, të bashkëpunojnë dhe, brenda kornizës së ligjit, të formojnë konsorciume me autoritete të tjera lokale, për të kryer detyra me interes të përbashkët.

17 Intervistë me Ajshe Bevernikun, Shefe e Kolegjisë së Integritit në BE. Mars 2021. Prishtinë.

18 Ibid

19 Intervistë me Ajshe Bevernikun, Shefe e Kolegjisë së Integritit në BE. Mars 2021. Prishtinë.

VLERËSIMI I ZBATIMIT TË RREGULLORES NR. 08/2011

Vlerësimi i zbatimit të Rregullores nr. 08/2011 ndahet në katër pjesë duke përfshirë


- I. ekzistencën e Zyrës Komunale për Integrim Evropian,
- II. përmbushjen e funksioneve të saj,
- III. përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë të saj,
- IV. bashkëpunimin me institucionet qendrore.

Ekzistenca e Zyrës Komunale për Integrim Evropian


Bazuar në rregulloren nr. 08/2011, neni 2, secila komunë themelon Zyrën Komunale për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejshëm: Zyra) dhe kjo Zyrë duhet të veprojë nën mbikëqyrjen e Komunës përkatëse.

Të dhënat e mbledhura nga faqet e internetit të komunave zbulojnë se shumica e komunave kanë një Zyrë për Integrim Evropian, siç tregohet në figurën më poshtë. Vetëm dy komuna, Mitrovica e Jugut dhe Graçanica kanë drejtorin për Integrim Evropian, ndërsa komunat e tjera kanë Zyrë. Këto zyra janë emëruar si Zyra për Integrim Evropian, Sektori për Integrim Evropian, Zyra për Drejtësi dhe Integrim Evropian, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian, por të gjitha funksionojnë nën mbikëqyrjen e Kryetarit në përputhje me Rregulloren nr. 08/2011.

Mungesa e një Zyre për Integrim Evropian në kabinetin e Kryetarit në përputhje me Rregulloren identifikohet si një nga sfidat kryesore drejt kryerjes me sukses të funksioneve, detyrave dhe përgjegjësisë



Zyrat Komunale për Integrim Evropian



Departmente që mbulojnë Integrimin Evropian.

të tyre si nëpunës civilë të integritit evropian.²⁰ Në këtë kontekst, ata nuk marrin pjesë në mbledhjen e këshillit të drejtorëve komunalë përveç mbledhjeve të tjera, por përkundrazi përfaqësohen nga drejtori i departamentit të tyre. Ky i fundit është pozicion politik që emërohet dhe mund të shkarkohet nga Kryetari i Komunës. Njëkohësisht, drejtori i departamentit nuk mund ta kuptojë domosdoshmërisht disiplinën dhe nuk ka kujtesën institucionale që ka nëpunësi civil. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në këshillin e drejtorëve komunalë konsiderohet si mekanizëm kyç për fuqizimin e rolit të Zyrave.²¹ Ky mekanizëm është mënyra e vetme për t'u përditësuar me aktivitetet, planet dhe përparësitë e komunës dhe ato mund të sigurojnë ekspertizën dhe mbështetjen në priorizimin dhe planifikimin në përputhje me agjendën e BE-së

Për më tej, 18 nga 38 komuna nuk kanë shënuar ndonjë informacion (emrin, mbiemrin, postën elektronike, numrin e telefonit) të nëpunësit civil përgjegjës për Integrimin Evropian në faqen e internetit të komunës së tyre. Kjo mund të interpretohet si mungesë e përgjegjësisë, mungesë transparence dhe/ose neglizhencë nga ana e komunave.

Lidhur me numrin e stafit në secilën komunë, neni 6.5 i Rregullores tregon se secili Kryetar i Komunës, në varësi të nevojave dhe buxhetit të Komunës, mund ta përcaktojë numrin e stafit. Të dhënat e mbledhura zbulojnë se secila komunë ka të paktën një shërbim civil përgjegjës për procesin e Integritit Evropian bazuar në Rregulloren (vetëm tri komuna kanë dy nëpunës civilë për çdo Zyrë).²² Sipas kreut të Kolegjiumit të Asociacionit për Integrimin Evropian, një nëpunës civil për çdo komunë është i mjaftueshëm për t'i kryer funksionet dhe përgjegjësitë e Zyrës në përputhje me Rregulloren, por problemi mbetet te fuqizimi i këtyre Zyrave.²³

Përmbushja e funksioneve të saj

Bazuar në rregulloren nr. 08/2011, Zyra ka disa funksione si më poshtë:

- **Koordinimi** i procesit të Integritit Evropian
- **Koordinimi** i procesit të zhvillimit të kornizës së rregullimit dhe politikave të Komunës të lidhura me Integrimin Evropian.
- **Pjesëmarrja** në caktimin e përparësive komunale.
- **Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi** i rregullt i zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike dhe përparësive komunale para Kryetarit të Komunës dhe autoriteteve qendrore.
- **Koordinimi** i ndihmës së BE-së dhe të tjerave të jashtme
- **Mbështetja** për të gjitha strukturat komunale në përmirësimin e konsulencave dhe dialogut civil me shoqërinë civile dhe me palët e tjera të interesuara dhe audiencën e gjerë në nivelin komunal.
- **Koordinimi dhe pjesëmarrja** në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që synojnë t'i zhvillojnë kapacitetet komunale për t'i përfunduar me sukses të gjitha reformat e nevojshme, përfshirë monitorimin.
- **Shtimi** i vetëdijesimit të administratës komunale, shoqërisë civile, medias, audiencës së biznesit mbi procesin e integritit në BE dhe promovimin e vlerave evropiane.

20 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

21 ibid.

22 Të dhënat e mbledhura nga kërkimet në faqet e internetit të komunave (38) (14 dhe 15 Prill, 2021).

23 Intervistë me Ajshe Bevernikun, Shefe e Kolegjisë së Integritit në BE. Mars 2021. Prishtinë.


Fjalët kryesore që përshkruajnë më së miri funksionet e Zyrës janë koordinimi dhe mbështetja. Koordinimi dhe mbështetja nuk janë dy koncepte lehtësisht të matshme dhe të kuantifikueshme. Megjithatë, kjo analizë mbledh disa këndvështrime përmes një grupi fokusi me nëpunës civilë, anketeve në internet dhe intervistave, për të vlerësuar zbatimin e këtyre funksioneve.

Në vlerësimin e funksionit të tyre për të bashkërenduar procesin e Integritimit Evropian dhe për caktimin e prioriteteve komunale, kemi parë se sa shpesh ata

janë të ftuar në takime me shefat e tjerë të drejtorive nga Kryetari i Komunës, dhe në cilat forma ofrojnë kontributin për përcaktimin e prioriteteve komunale.

Të dhënat e pyetësorit zbulojnë se 8 nëpunës civilë nga tetë komuna nuk janë ftuar kurrë në një takim me bordin e drejtorëve nga kabineti i Kryetarit të Komunës. 11 kanë deklaruar se nganjëherë janë të ftuar, duke rezultuar në gjithsej 18 Zyra që shumicën e kohës janë lënë pas dore nga kabineti i Kryetarit të Bashkisë. Siç shihet në figurën më poshtë, vetëm

Sa shpesh jeni i ftuar nga kabineti i Kryetarit në takimet me Këshillin e Bordit?



8 nëpunës civilë kanë deklaruar se janë gjithmonë të ftuar në takimin me bordin e drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës.

Nga ana tjetër, ky takim është mekanizmi kryesor përmes të cilit nëpunësit civilë të integritit evropian mund të informohen mbi projektet dhe përparësitë në vazhdim, në mënyrë që të mund të japin reagimet dhe të koordinojnë procesin e integritit evropian, të ndihmojnë në caktimin e përparësive dhe të sigurojnë monitorim, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre dokumenteve strategjike dhe të përparësive komunale. Për më tej, të gjithë pjesëmarrësit në grupet e fokusit e kanë konsideruar pjesëmarrjen në këto takime edhe si dimension thelbësor për kryerjen me sukses të rolit të vet. Njëri nga nëpunësit civilë e sheh këtë mekanizëm si mënyrën më produktive për të dhënë reagime dhe për t'i çuar më tej reformat që burojnë nga agjenda e BE-së.²⁴

Për më tej, siç u përmend më lart, ekziston një organ brenda strukturës së Asociacionit të Komunave të Kosovës, i quajtur Kolegji i Integritit në BE, që synon të identifikojë dhe të promovojë nevojat dhe interesat e të gjitha Zyrave nëpër komuna. Në këtë kontekst, ata i kanë dërguar kërkesa të drejtpërdrejta Kabinetit të Kryetarit të Komunës, pasi Kryetari i ri ka marrë detyrën, për të shqyrtuar seriozisht rolin e nëpunësit civil të integritit Evropian brenda komunës së vet dhe për t'i ftuar ata në të gjitha takimet me Bordin e Drejtorëve.²⁵ Megjithatë, kjo kërkesë nuk është detyruese dhe mbetet e karakterit këshillues .

Një sfidë tjetër kyçe e identifikuar në përmbushjen e funksioneve të Zyrës në lidhje me mbështetjen dhe përmirësimin e dialogut me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara, si dhe rritjen e vetëdijesimit të administratës komunale, shoqërisë civile, medias, biznesit dhe publikut për procesin e integritit në BE është mungesa e buxhetit. Disa nga këto Zyra kanë treguar interes për të organizuar ak-

tivitete simbolike në data të rëndësishme si Dita e Evropës, por atyre u mungon buxheti i nevojshëm për këtë.²⁶ Pra, mbetet shumë sfiduese kryerja e funksionit mbështetës drejt rritjes së vetëdijesimit midis aktorëve të ndryshëm në lidhje me procesin e integritit në BE dhe drejt përmirësimit të konsultimeve me sektorin e shoqërisë civile.

Në përgjithësi, analiza e vlerësimit tregon se pak funksione të Zyrës nuk zbatohen, ndërsa disa funksione të tjera koordinuese janë kryer pjesërisht. Dy kufizime kryesore të identikuara përfshijnë mungesën e buxhetit dhe mungesën e pjesëmarrjes në takime me organet e tjera vendimmarrëse të komunës. Kjo e fundit pasqyron qartë rolin e kufizuar të nëpunësve civilë të integritit evropian brenda strukturës së komunës.

24 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

25 Intervistë me Ajshe Bevernikun, Shefe e Kolegjisë së Integritit në BE. Mars 2021. Prishtinë.

26 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

Përmbushja e detyrave dhe përgjegjësi të saj

Bazuar në Rregulloren nr. 08/2011, Zyra ka disa detyra dhe përgjegjësi:

- **Ofrimi i mbështetjes profesionale**, ekspertizës dhe këshillave për Kryetarin e Komunës dhe drejtorët komunalë për përcaktimin e prioritetëve komunale në fushën e integritit evropian.
- **Bashkërendimi** i ngushtë me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Asamblesë Komunale dhe Shefin e Drejtorive si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale për zhvillimin e politikave komunale, kornizën e zhvillimit rregullator dhe hartimin e planit vjetor komunal që synon të pasqyrojë përparësitë dhe objektivat e të gjitha dokumenteve strategjike kombëtare për integrimin evropian dhe marrëdhëniet Kosovë-BE.
- **Mbështetja dhe këshillat** për shërbimet juridike të komunës dhe të komitetëve të asamblesë komunale që synojnë të pasqyrojnë aqis dhe politikat përkatëse të BE-së.
- **Koordinim i ngushtë dhe bashkëpunim** me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Zyrën për Integrimin Evropian në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve komunale brenda kornizave të dokumenteve strategjike kombëtare për integrim evropian..
- **Kryerja e monitorit, raportimit dhe vlerësimit** të rregullt të prioritetëve komunale dhe zbatimi i dokumenteve strategjike si dhe aktiviteteve përkatëse në kuadër të dokumenteve strategjike kombëtare

- **Koordinim i ngushtë dhe bashkëpunim** me Ministrinë përgjegjëse të Pushtetit Lokal dhe Ministrinë e Integritit Evropian për t'u siguruar që sfidat, nevojat, përparësitë, si dhe raportimi i aritjeve komunale të pasqyrohen në procedurat e rregullta të punës së strukturave koordinuese ndërinstytucionale për integrimin evropian
- **Në bashkëpunim të ngushtë** me Ministrinë Përgjegjëse të Pushtetit Lokal dhe atë të Integritit Evropian, brenda kornizave komunale, koordinim i programimit dhe zbatimit të BE-së dhe ndihmës tjetër të burimit të jashtëm brenda kornizave të komunës.
- **Koordinimi dhe bashkëpunimi** me Zyrën për Komunikim dhe Informim Publik në Komunë në lidhje me çështjet e komunikimit dhe informacionit për Integrimin Evropian..


Ashtu si funksionet e Zyrës, fjala kyçe që përshkruan detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre Zyrave përfshin koordinimin, ofrimin e mbështetjes dhe këshillimit, bashkëpunimin dhe monitorimin, si dhe raportimin e rregullt.

Ofrimi i mbështetjes dhe këshillimit profesional për përcaktimin e prioritetëve komunale nuk është praktikë në këto Zyra.²⁷ Nëpunësve civilë nuk u është dhënë mundësia të këshillojnë Kryetarin e Komunës ose ndonjërin nga Drejtoritë e Departamenteve në lidhje me përcaktimin e përparësive për departamentet përkatëse ose komunën në përgjithësi. Për shembull, në rastin e Mitrovicës Jugore, një komunë që nuk ka Zyrë për integrim Evropian, por dy nëpunës civilë që mbulojnë këto përgjegjësi brenda Drejtorisë për Integrim Evropian dhe Mirëqenie Sociale, kurrë nuk kanë qenë në takim me Bordin e Drejtorëve ose në ndonjë takim tjetër niveli të lartë, pasi ato përfaqësohen gjithmonë nga Drejtori i tyre (pozicion politik i zgjedhur nga Kryetari i Komunës).

27 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.


Për më tej, siç shihet në figurën poshtë, 19 nëpunës civilë të integritit evropian nuk janë ftuar kurrë ose rrallë ftohen në takime në lidhje me planifikimin e buxhetit komunal, ndërsa vetëm 8 ftohen gjithmonë. Me këtë parasysh, bëhet sfiduese që të shtyhet përpara çfarëdo politike publike lokale që buron nga agjenda e BE-së.

Sa shpesh jeni i ftuar në takimet e planifikimit buxhetor?




Ata gjithashtu rrallë ose kurrë nuk ftohen për përgatitjen e ndonjë strategjie ose akti tjetër juridik në komunë. Siç shihet në figurën më poshtë, 6 kanë deklaruar se kurrë nuk ishin ftuar nga Kryetari i Komunës ose ndonjë nga departamentet për të kontribuar në këtë drejtim, e 16 janë përgjigjur se ndonjëherë janë ftuar. Nga ana tjetër, vetëm 8 janë të ftuar gjithmonë në takime/ grupe pune të tilla.

Sa shpesh jeni i ftuar në grupe pune për të hartuar ndonjë rregullore ose akte të tjera ligjore komunale?



Për vlerësimin e mbështetjes dhe këshillave të ofruara për komunën, posaçërisht për komitetet e asamblesë komunale, i kemi pyetur nëpunësit civilë të integritit evropian nëse kanë ofruar ndonjëherë këshilla ose mbështetje për asamblenë komunale, dhe nëse po, në çfarë forme. Siç tregohet në figurën më poshtë, 12 janë përgjigjë se nuk kanë ofruar kurrë mbështetje të tillë, e 15 kanë thanë po.

Gjatë punës suaj në komunë, a keni ofruar ndonjëherë mbështetje për komitetet e asamblesë komunale?



Mbështetja e ofruar ishte në të dy format, të shkruar dhe të folura. Pak sish kanë dhënë mbështetje në hartimin e rregulloreve të ndryshme si pjesë e grupeve të punës, ose kanë ofruar këshilla ligjore për të kontrolluar për pajtueshmëri me acquis të BE-së. Megjithatë, numri i atyre që nuk kanë bashkëpunuar kurrë me asamblenë komunale në formën e ofrimit të mbështetjes ose këshillimit mbetet i lartë (12 zyra). The close coordination and collaboration with central level institutions is discussed in section IV.

Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e nivelit qendror diskutohet në seksionin IV.

Për ta përmbledhë, analiza e vlerësimit demonstroi zbatim të kufizuar të detyrave dhe përgjegjësi të Zyrës, për shkak të faktorëve të identifikuar më lart, përfshi këtu mungesën e ftesës nga zyra e Kryetarëve për të marrë pjesë në takimin e bordit të drejtorëve, për të ofruar mbështetje për komitetet e asamblesë komunale, ose për të qenë pjesë e ndonjë grupi punues për hartimin e rregulloreve komunale ose akteve të tjera ligjore.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore

Bazuar në Rregulloren nr. 08/2011, për t'i përbushë detyrat, Zyra duhet ta koordinojë punën rregullisht dhe nga afër me institucionet e mëposhtme:


- Zyra për Integrim Evropian (ish-Ministria e Integritimit Evropian),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Ministria e Financave dhe institucionet e tjera përkatëse.

Së pari, për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit, i kemi pyetur nëpunësit civilë (përmes pyetësorit në internet) çfarë marrëdhënie kanë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (shumë të mira, të mira, jo të mira, pa marrëdhënie). Siç shihet në figurën më poshtë, 18 kanë deklaruar se kanë marrëdhënie shumë të mirë dhe 9 marrëdhënie të mirë. Askush nuk u përgjigj se nuk kishte marrëdhënie të mira ose se ishte pa marrëdhënie.

E njëjta pikëpamje u mbajt gjatë diskutimeve në grupe fokusi, ku të gjithë u pajtuan se kanë marrëdhënie shumë të mira pune me Ministrinë dhe se i raportojnë dy herë në vit mbi përgjegjësitë e nivelit lokal që dalin nga agjenda e BE-së.²⁸ Të njëjtën pikëpamje e mbante Drejtori i Departamentit për Integrim në BE dhe Koordinim të Politikave në MAPL.²⁹

Së dyti, për ta vlerësuar nivelin e bashkëpunimit midis nëpunësve civilë dhe Ministrisë së Financave, e kemi bërë të njëjtën pyetje përmes anketës në internet. Siç shihet në figurën më poshtë, 22 kanë deklaruar se nuk kanë fare marrëdhënie me Ministrinë e Financave, 2 kanë shënuar marrëdhënie të mirë, dhe 3 u përgjigjën se kishin marrëdhënie shumë të mirë.


Çfarë marrëdhënie pune keni me Ministrinë e Administratës Publike Lokale?



28 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

29 Intervistë me Shkelqim Jakupin, Drejtor i Departamentit për Integrim në BE dhe Koordinim të Politikave. 11 Mars 2021. Prishtinë.

Çfarë marrëdhënie pune keni me Ministrinë e Financave?




Gjatë diskutimeve në grupe fokusi, mbahej e njëjta pikëpamje dhe ata u pajtuan se nuk kanë fare marrëdhënie me Ministrinë e Financave (MF). Sipas tyre, e gjithë puna është bërë me MAPL dhe ata nuk kanë ndonjë formë bashkëpunimi me MF. Njëri deklaroi se komuna ka zyrtarin e vet të financave, i cili bashkëpunon me Ministrinë, prandaj nuk ka nevojë që ata si nëpunës civilë të integritit evropian të koordinojnë drejtpërdrejt me MF. Në këtë kontekst, një nëpunës tjetër civil deklaroi se ka edhe hapësirë për ndryshimin e rregullores, për të përjashtuar MF,

pasi asnjë formë a nevojë e komunikimit nuk është e pranishme.

Së treti, për ta vlerësuar nivelin e bashkëpunimit midis nëpunësve civilë dhe Zyrës për Integrim Evropian, e kemi bërë të njëjtën pyetje përmes anketës në internet. Siç shihet në figurën më poshtë, 5 janë përgjigjë se kanë marrëdhënie shumë të mirë, 11 janë përgjigjë se kanë marrëdhënie të mirë, 2 marrëdhënie jo të mirë dhe 9 nuk kanë fare marrëdhënie.

Çfarë marrëdhënie pune keni me Zyrën për Integrim Evropian (ish-Ministria e Integritimit Evropian)?



Nga ana tjetër, gjatë grupit të fokusit, të gjithë u pajtuan se nuk kanë bashkëpunim me Zyrën për Integrim Evropian. Për të ilustruar këtë mungesë bashkëpunimi, njëri nga pjesëmarrësit deklaroi: "Unë as nuk e di se ku janë zyrat e tyre, dhe pasi Ministria e tyre u shpërbë, nuk di çka ndodhi me institucionin".³⁰ Në këtë kontekst, një tjetër deklaroi se nëse ndryshohet rregullorja, roli dhe bashkëpunimi me këtë Zyrë duhet të rishikohet pasi deri sot nuk kemi pasë ndonjë komunikim me ta.


Në përgjithësi, nëpunësit civilë duket se kanë marrëdhënie shumë të mira pune me MAPL, ndërsa i raportojnë dy herë në vit. Nga ana tjetër, nuk kanë ndonjë marrëdhënie me dy institucionet e tjera të qeverisë qendrore, MF dhe Zyrën për Integrim Evropian, të përmendura në Rregulloren nr. 08/2011.

30 Informacion nga Grupi i Fokusit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE

Ky seksion adreson nevojat për ndërtimin e kapaciteteve që kanë identifikuar nëpunësit civilë komunalë për integrimin në BE për ta fuqizuar rolin e Zyrës. Shumica u pajtuan se roli i komunës dhe roli i tyre është thelbësor për avancimin e agjendës së BE-së në nivel lokal, por sipas tyre ky rol nuk pranohet si i tillë brenda strukturave të komunës, përfshirë zyrën e Kryetarit.³¹ Siç shihet në figurën më poshtë, 15 kanë deklaruar se ndonjëherë përballen me probleme për të marrë të dhëna nga departamentet e tjera për qëllime monitorimi dhe raportimi. Nga ana tjetër, 12 thanë se kurrë nuk janë përballë me probleme të tilla. Megjithatë, problemi është i dukshëm, sepse më shumë se gjysma e komunave përballen me probleme të tilla, ose duhet ta përdorin kanalën e miqësisë për të mbledhë informacion për qëllime monitorimi e raportimi.

Gjatë punës suaj të monitorimit dhe vlerësimit, a keni ndeshë ndonjëherë probleme nga kolegët e departamenteve të tjera për të mbledhë të dhëna?



31 Ibid.

Për ta ilustruar mungesën e rëndësisë së rolit të tyre, njëri nga nëpunësit civilë deklaroi se departamentet e tjera ndonjëherë thonë: pse t'ju raportojmë juve, duke e bërë më të vështirë për nëpunësit civilë të integrit në BE që të mbledhin të dhëna monitoruese.³² Nga ana tjetër, monitorimi dhe raportimi i zbatimit të reformave që vijnë nga BE mbetet njëri nga rolet kryesore të këtyre Zyrave.

Për më tej, 13 nëpunës civilë të integrit evropian u përgjigjën me Po kur u pyetën nëse kanë marrë trajnim mbi aplikimin për fonde të BE-së, dhe 14 thanë se nuk kanë marrë trajnime të tilla siç shihet në figurën më poshtë.


A keni marrë ndonjë trajnim në lidhje me aplikimin për fonde të BE-së?



32 Informacion nga Grupi i Fokosit (përmes platformës zoom) me nëpunës civilë nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. 22 Prill 2021.

Nga ana tjetër, kur u pyetën nëse kanë aplikuar për fonde të BE-së në emër të komunës ku punojnë, 9 thanë se e kishin bërë këtë, kurse 18 thanë jo, siç shihet në figurën më poshtë. Këto të dhëna janë në përputhje me nevojat e trajnimit të identifikuar nga nëpunësit civilë, duke përfshirë trajnimin se si të aplikohet për financim nga BE (të dhënat nga anketa online).

A keni aplikuar ndonjëherë për financim nga BE?



Për më tej, i kemi pyetur nëpunësit civilë komunalë për integrim evropian që t'i identifikojnë nevojat për trajnim, gjë që do t'i ndihmonte edhe për ta fuqizuar rolin e tyre brenda komunës. Lista e nevojave të njohura përfshin :

1 Si të aplikohet për fonde të BE-së (12 kanë përmendë trajnime për fondet e BE-së, përveç trajnimit për fonde në përgjithësi).

2 Cikli i Menaxhimit të Projektit

3 Vizita studimore në vendet e tjera të BE-së


4 Bashkëpunim me organizata të tjera ndërkombëtare

5 Kurse të gjuhës angleze

6 Trajnim për përgatitjen e raportit periodik

Siç shihet, disa nga nëpunësit civilë të integritit evropian kanë identifikuar nevojën për të ndjekë kurse të gjuhës angleze, dhe të dhënat e pyetësorit njëkohësisht zbulojnë se 14 kanë aftësi të kufizuara në gjuhën angleze, ndërsa nuk janë në gjendje të marrin pjesë në seminar/trajnim në anglisht. 13 kanë deklaruar se kanë aftësi më të mira të anglishtes dhe mund të ndjekin trajnime në anglisht, kurse pak sish flasin qartë siç shihet në figurën më poshtë

Çfarë niveli të anglishtes flisni?



Më se gjysma e të gjithë nëpunësve civilë nuk kanë aftësi gjuhësore për të marrë pjesë në seminar, trajnim ose kurs në gjuhën angleze, duke pasqyruar pengesën kryesore në koordinimin e fondeve të integritit në BE, lehtësimin e dialogut me aktorë të jashtëm dhe aplikimin për fondet e BE-së dhe për fondet e tjera ndërkombëtare.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME TË POLITIKAVE

Ky raport i politikave ka vlerësuar zbatimin e Rregullores nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrës Komunale për Integrim Evropian dhe avokon për fuqizimin e mëtejshëm të këtyre Zyrave.

Ky raport i politikave ka përdorë një qasje cilësore për ta vlerësuar zbatimin e Rregullores nr. 08/2011 pasi shumica e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të vlerësuara janë të natyrës koordinuese, mbështetëse e ndihmëse. Për vlerësimin e këtyre roleve, duhet të mblidhen të dhëna të dorës së parë, duke përfshirë perceptimet nga aktorët kryesorë të përfshirë. Kështu, për këto qëllime, ky raport i politikave ka përdorë metodën e triangulimit të të dhënave duke përfshirë a) marrjen e të dhënave nga webfaqet e 38 komunave, b) kryerjen e intervistave me aktorët kryesorë, përfshirë MAPL-në dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës, c) realizimin e një grupi fokusi me punonjësit civilë të integritit evropian nga shtatë komunat më të mëdha të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj), dhe d) zhvillimin e një anketimi në internet me të gjithë nëpunësit civilë të integritit evropian nga 38 komunat.

Analiza demonstroi se Rregullorja nr. 08/2011 ka zbatim të kufizuar në të gjitha komunat e Kosovës. Një numër sfidash e problemesh të identifikuar përfshijnë

- Dy komuna nuk kanë fare Zyrë për Integrim Evropian.
- Shumicës së nëpunësve civilë komunalë të integritit evropian asnjëherë nuk u është kërkuar ndihmë në caktimin e përparësive të politikave publike lokale.
- Më se gjysma e tyre rrallë ose kurrë nuk këshillohen për hartimin e buxhetit komunal ose nuk ftohen në grupe punuese për të hartuar rregulloret ose strategjitë komunale.
- Pothuajse gjysma e tyre kurrë nuk kanë ofruar mbështetje/këshilla për komitetet e asamblesë komunale.
- Më se gjysma e tyre pohuan se ndonjëherë hasin në probleme me drejtoritë e tjera për mbledhjen e informacionit për qëllime monitorimi dhe raportimi.
- Rreth 70% e nëpunësve civilë nuk ftohen kurrë ose rrallë ftohen në takim me mbledhjen e këshillit të drejtorëve, të udhëhequr nga kryetari i komunës.

- Gjysma e tyre nuk janë trajnuar asnjëherë se si të aplikojnë për fonde të BE-së dhe më se gjysma nuk kanë aplikuar kurrë për asnjë lloj financimi prej BE-së.
- Më se gjysma e të gjithë nëpunësve civilë nuk kanë aftësi gjuhësore për të marrë pjesë në seminar, trajnim ose kurs të dhënë në gjuhën angleze.
- Ata nuk janë në gjendje të organizojnë ngjarje për rritjen e vetëdijesimit midis aktorëve komunalë dhe aktorëve të shoqërisë civile rreth reformave të agjendës evropiane, për shkak të mungesës së buxhetit.
- Të gjithë kryetarët e komunave duhet t'i ftojnë nëpunësit civilë të integritit evropian gjatë takimit të këshillit të drejtorëve. Me këtë parasysh, ata do të informohen rreth planeve dhe aktiviteteve komunale dhe do të kenë mundësi të japin komentet e tyre.
- Të gjitha kabinetet e kryetarëve të komunave dhe drejtorët e departamenteve duhet të këshillohen me nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian për caktimin e përparësive të politikave publike lokale që t'i çojnë përpara reformat e dala nga agjenda e Evropiane e Kosovës.

Prandaj, sipas gjetjeve tona të bazuara në evidencë dhe me qëllim të fuqizimit të Zyrave Komunale për Integritim Evropian, ky raport i politikave ofron rekomandimet e mëposhtme:

- Mitrovica e Jugut dhe Graçaninca duhet të themelojnë një Zyrë Komunale për Integritim Evropian dhe kjo zyrë duhet të veprojë nën mbikëqyrjen e kryetarit të komunës përkatëse, në përputhje me nenin 2 të Rregullores nr. 08/2011.
- Me të marrë detyrën, çdo kryetar komune me stafin e vet ekzekutiv duhet të informohet për rolin dhe funksionet e Zyrës. Për më tej, Rregullorja nr. 08/2011 duhet t'u sigurohet atyre përmes cilitdo kanal komunikimi. Marr këtë parasysh, do të ulej numri i problemeve të hasura gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të të dhënave.
- Nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian duhet të konsultohen kur hartohet buxheti komunal, pasi dimensionin e buxhetit mbetet parakushti kryesor për zbatimin e çdo politike publike lokale.
- Nëpunësit civilë komunalë të integritit evropian duhet të trajnohen lidhur me aplikimin për fonde të BE-së.
- Rregullorja nr. 08/2011 duhet të ndryshohet për të rishikuar rolin e bashkëpunimit të këtyre Zyrave me Ministrinë e Financave dhe Zyrën për Integritim Evropian (ish Ministria e Integritit Evropian).

SHTOJCA A:

Anketë mbi rolin e Komunës në Procesin e Integrit Evropian

1 Emri dhe Mbiemri* _____

2 Komuna* _____

3 Sa nëpunës civilë të integrit evropian janë në komunën tuaj?

4 Çfarë niveli të anglishtes flisni? *

- Unë nuk e kuptoj (kam zero njohuri të gjuhës angleze)
- Fillestar (mund të komunikoj në disa tema të thjeshta dhe di disa fraza)
- I ndërmjetmë (mund të kuptoj dhe të marr pjesë në trajnim ku flitet vetëm anglisht)
- I para-avancuar (komunikoj qartë për një larmi temash dhe përdor fjalor të pasur anglisht)
- I avancuar (e flas njësoj si gjuhën time amtare)

5 Çfarë marrëdhënie pune keni me Ministrinë e Administratës Publike Lokale?

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Nuk kam marrëdhënie

6 Çfarë marrëdhënie pune keni me Ministrinë e Financave?

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Nuk kam marrëdhënie

7 Çfarë marrëdhënie pune keni me Zyrën për Integrim Evropian (ish-Ministria e Integritimit Evropian)?

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Jo aq të mirë
- Nuk kam marrëdhënie

8 Sa shpesh jeni i ftuar nga kabineti i Kryetarit në takimet me Këshillin e Bordit?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Kurrë

9 Sa shpesh jeni i ftuar në takimet e planifikimit buxhetor?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Kurrë

10 Sa shpesh jeni i ftuar në një grup pune për të hartuar një rregullore ose akte të tjera ligjore komunale?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Kurrë

11 Gjatë punës suaj në komunë, a keni ofruar ndonjëherë mbështetje për komitetet e asamblesë komunale?

- Po
- Jo

12 Nëse i jeni përgjigjë pyetjes së mësipërme me PO, atëherë çfarë këshille keni dhënë dhe në çfarë forme?

13 A merrni ndonjë trajnim për aplikim financimi nga BE?

- Po
- Jo

14 A keni aplikuar ndonjëherë për financim nga BE?

- Po
- Jo

15 Gjatë punës suaj të monitorimit dhe vlerësimit, a keni ndeshë ndonjëherë probleme nga kolegët e departamenteve të tjera për të mbledhë të dhëna?

- Gjithmonë
- Ndonjëherë
- Kurrë

16 Si e vlerësoni rolin e komunës në procesin e Integritimit Evropian (përshkruani me dy ose tri fjali)?

17 Në cilin nivel, nga 1- 5, e vlerësoni zbatimin e Rregullores nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian (sa më afër 5 aq më afër zbatimit të plotë)?

18 Çfarë lloj trajnimi ju duhet? Ju lutemi renditni 3 fusha më së shumti.

19 Si mendoni se roli i Zyrës suaj mund të fuqizohet brenda komunës?

20 Sipas mendimit tuaj, në nivelin komunal, cilat reforma janë më të vështirat për t'u zbatuar?

SHTOJCA B: Informacioni i kontaktit në lidhje me Zyrat e Integrit Evropian në Komunitet e Kosovës dhe nëpunësit civilë

Komuna	Zyra/Departamenti	Nëpunësit civilë
Deçan	Zyra për Komunitete dhe Integrim Evropian	Nezir Balaj E-mail: nezir.balaj@rks-gov.net
Gjakovë	Spektori i Integrit Evropian	Arbër Gola Email: arber.gola@rks-gov.net Tel.: 038/200 – 44092
Glllogoc	Zyra për Integrim Evropian	Gentianë Morina Email: gentiane.r.morina@rks-gov.net
Gjilan	Zyra për Integrim Evropian	Burim Elezi E-mail: burim.elezi@rks-gov.net Tel.: +383 (44) 212 336
Dragash	Zyra për Ligj dhe Integrim Evropian	Adem Emini Email: adem.emini@rks-gov.net
Istog	Zyra për Integrim Evropian	Muhamet Gusturanaj E-mail: muhamet.gusturanaj@rks-gov.net
Kaçanik	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Hidajete Guri Email: hidajete.hoxha-guri@rks-gov.net

Komuna	Zyra/Departamenti	Nëpunësit civilë
Klinë	Zyra për Integrim Evropian	Have Thaçi- Fejza Email: have.thaqi@rks-gov.net Tel.: 03820043756
Fushë Kosovë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Nurije Fazliu Email: nurije.fazliu@rks-gov.net
Kamenicë	Zyra për Integrim Evropian	Zijadin Thaqi E-mail: zijadin.thaci@rks-gov.net Tel: 03820047645
Leposaviq	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Dragana Milutinović
Lipjan	Zyra për Integrim Evropian	Linda Shahini E-mail: linda.shahini@rks-gov.net
Obiliq	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Kushtrim Mirena E-mail: kushtrim.mirena@rks-gov.net
Rahovec	Zyra për Integrim Evropian	Arben Gashi E-mail: arben.a.gashi@rks-gov.net

Komuna	Zyra/Departamenti	Nëpunësit civilë
Pejë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Teuta Blaka & Tahir Shala E-mail: Teuta.Blaka@rks-gov.net ;
Podujevë	Zyra për Integrim Evropian	Ylber Salihu E-mail: Ylber.Salihu@rks-gov.net Tel.: 038/200 41-017
Prishtinë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Ajshe Berveniku E-mail: ajshe.berveniku@rks-gov.net
Prizren	Zyra për Integrim Evropian	Eleonora Fetollari Buç E-mail: eleonora.fetollari@rks-gov.net Tel.: +381(0) 38 200 44-752
Skënderaj	Zyra për Integrim Evropian	Mirsad Gashi E-mail: mirsad.gashi@rks-gov.net Tel: +383 44 418 571
Shtime	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Ekrem Reqica E-mail: ekrem.reqica@rks-gov.net;
Shtërpcë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Tasa Radic - Zyrtar E-mail: tasa.radic@rks-gov.net
Suharekë	Zyra për Integrim Evropian	Shaban Asllanaj E-mail: shaban.asllanaj@rks-gov.net Tel: +383 29 271 608

Komuna	Zyra/Departamenti	Nëpunësit civilë
Ferizaj	Zyra për Integrim Evropian	Hilmi Mustafa E-mail: hilmi.mustafa@rks-gov.net Tel: 038 200 46 072
Viti	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Florent Ymer, E-mail: florent.ymeri@rks-gov.net ,
Vushtrri	Zyra për Integrim Evropian	Xhavit Mehmeti - E-mail: xhavit.mehmeti@rks-gov.net
Zubin Potok	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Latinka Utvic
Zveçan	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Jelena Djokic
Malishevë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Haxhi Krasniqi
Novobërdë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Arbenita Llapashtica
Mitrovicë e Veriu	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Hamit Mripa E-mail: hamit.mripa@rks-gov.net;

Komuna	Zyra/Departamenti	Nëpunësit civilë
Mitrovicë e Jugu	Drejtoria për Integrim Evropian dhe Mirëqenie Sociale	Sadije Jashari E-mail: sadije.jashari@rks-gov.net
Junik	Zyra për Integrim Evropian	Turim Ganijaj E-mail: turim.ganijaj@rks-gov.net Tel: +383 49 760 230
Hani i Elezit	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Avni Bushi E-mail: avni.bushi@rks-gov.net;
Mamushë	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Fahri Kruezi E-mail: fahri.kruezi@rks-gov.net Tel: 0038 345 271 096
Graçanicë	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Integrim Evropian	Nebojša Milovanović E-mail: ebojsa.milovanovic@rks-gov.net
Ranillug	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Arton Dubova E-mail: arton.dubova@rks-gov.net
Partesh	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Jovica Maksimovic
Kllokot	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Evropian	Përparim Rexhepi E-mail: perparim.rexhepi@rks-gov.net;

